VENDIM
Nr.184, datë 30.6.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE "RADIO UNIVERS"
SUBJEKTIT: SHOQËRIA "RADIO UNIVERS" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor", dhe rregullores "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "Radio Univers" sh.p.k., për t'u licencuar si operator radiofonik privat vendor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë shoqërisë "Radio Univers" sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qarqet Tiranë-Durrës-Fier-Vlorë.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati